

Memorandum Bashkëpunimi

I lidhur me dt: 17.04.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini;
2. Organizatës ndërkombëtare "UP with People" të cilën e përfaqëson Drejtori për Europë z. Brad Bungum.

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët për mbajtjen e aktiviteteve kulturo-artistike, sociale, punëtoritë e ndryshme në shkolla të mesme dhe shumë aktivitete në ndihmë të komunitetit në Komunën e Gjakovës.

Neni 2 Përshkrimi i organizatës

Organizata "Up With People" është themeluar duke u bazuar në principet që përmes muzikës si element kryesor të komunikojë dhe inspirojnë njerëzit. Përmes muzikës dhe aktiviteteve të ndryshme, Organizata "Up With People" nxit të rinjtë për të qenë agentë pozitivë të ndryshimeve për një botë më shpresëdhënëse, të besueshme dhe paqësore. Grupi i "Up With People" ka performuar në më shumë se 70 shtete të botës dhe është ndjekur nga më shumë se 1.1 miliardë njerëz.

Produksioni i fundit i "Up With People Live On Tour 2018" fokusohet në shpresat tona për një të nesërme më të mirë. Performanca përfshinë këngë dhe vallëzime ndërkombëtare, potpuri zbavitëse të pop-it, dhe këngë origjinale të kompozura për të inspiruar njerëzit drejt përkushtimit personal për të mbajtur shpresat për të ardhmen në komunitetin e tyre.

Për herë të parë në historinë 53-vjeçare të "Up With People", 105 të rinj nga 18 shtete do të vizitojnë Kosovën nga data 22 Maj - 5 Qershor, 2018 duke qëndruar në familjet nikoqire Komunën e Gjakovës dhe duke performuar në Gjakovë dhe Prishtinë.

Në Gjakovë në Teatrin e Qytetit "Hadi Shehu" në datat 25 dhe 26 Maj 2018 do të mbahen dy shfaqje muzikore nga të rinjtë e "Up with People".

Neni 3
Obligimet e Komunës

3.1. Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 15,000.00€ për përkrahjen e aktiviteteve të parapara sipas agjendës së Organizatës “Up with People”. Mjetet që do të ndahen për Organizatën “Up with People” do të ekzekutohen pas pranimi të faturave të cilat do të jenë të argumentuara nga “Up with People” në bazë të shpenzimeve të parapara.

3.2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pas pranimi të të gjitha faturave që pasqyrojnë shpenzimet e bëra nga Organizata “Up with People” dhe pas rekomandimit të Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë financiare të Zyrës së Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat e ekzekutimit të pagesës në xhirollogarinë e organizatës me nr. të llogarisë BE17310187387821.

Neni 4
Obligimet e “Up with People”


Organizata “Up with People” obligohet që ti sjellë të gjitha faturat për shpenzimet e bëra lidhur me aktivitetet e saj në Gjakovë ku përmes të cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra. Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

Neni 5
Hyrja në fuqi


Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e mirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

PALËT

Komuna e Gjakovës




Ardian Gjini



UP With People



Brad Bungum



Memorandum Bashkëpunimi

I lidhur me dt: 17.04.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini;
2. Organizatës ndërkombëtare "UP with People" të cilën e përfaqëson Drejtori për Europë z. Brad Bungum.

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët për mbajtjen e aktiviteteve kulturo-artistike, sociale, punëtoritë e ndryshme në shkolla të mesme dhe shumë aktivitete në ndihmë të komunitetit në Komunën e Gjakovës.

Neni 2 Përshkrimi i organizatës

Organizata "Up With People" është themeluar duke u bazuar në principet që përmes muzikës si element kryesor të komunikojë dhe inspirojë njerëzit. Përmes muzikës dhe aktiviteteve të ndryshme, Organizata "Up With People" nxit të rinjtë për të qenë agentë pozitivë të ndryshimeve për një botë më shpresëdhënëse, të besueshme dhe paqësore. Grupi i "Up With People" ka përformuar në më shumë se 70 shtete të botës dhe është ndjekur nga më shumë se 1.1 miliardë njerëz.

Produksioni i fundit i "Up With People Live On Tour 2018" fokusohet në shpresat tona për një të nesërme më të mirë. Përformanca përfshinë këngë dhe vallëzime ndërkombëtare, potpuri zbavitëse të pop-it, dhe këngë origjinale të kompozuar për të inspiruar njerëzit drejt përkushtimit personal për të mbajtur shpresat për të ardhmen në komunitetin e tyre.

Për herë të parë në historinë 53-vjeçare të "Up With People", 105 të rinj nga 18 shtete do të vizitojnë Kosovën nga data 22 Maj - 5 Qershor, 2018 duke qëndruar në familjet nikoqire Komunën e Gjakovës dhe duke përformuar në Gjakovë dhe Prishtinë.

Në Gjakovë në Teatrin e Qytetit "Hadi Shehu" në datat 25 dhe 26 Maj 2018 do të mbahen dy shfaqje muzikore nga të rinjtë e "Up with People".

Neni 3

Obligimet e Komunës

3.1. Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 15,000.00€ për përkrahjen e aktiviteteve të parapara sipas agjendës së Organizatës “Up with People”.

Mjetet që do të ndahen për Organizatën “Up with People” do të ekzekutohen pas pranimi të faturave të cilat do të jenë të argumentuara nga “Up with People” në bazë të shpenzimeve të parapara.

3.2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pas pranimi të të gjitha faturave që pasqyrojnë shpenzimet e bëra nga Organizata “Up with People” dhe pas rekomandimit të Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë financiare të Zyrës së Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat e ekzekutimit të pagesës në xhirollogarinë e organizatës me nr. të llogarisë BE17310187387821.

Neni 4

Obligimet e “Up with People”

Organizata “Up with People” obligohet që ti sjellë të gjitha faturat për shpenzimet e bëra lidhur me aktivitetet e saj në Gjakovë ku përmes të cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra.

Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e mirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

PALËT

Komuna e Gjakovës



Ardian Gjini

UP With People

Brad Bungum